



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT ENUAR V MERKO
ZYRA PËRMBARIMORE E.G BAILIFF SERVICE

Adresa: Rr. "Themisokli Gërmenji", Pallati "Ambasador 1", Kati 2, Tiranë; Cel: +355 68 21 93 435; e-mail :enuar.merko@gmail.com



Nr. 12479 . Prot

Tiranë më 29.12.2021

URDHËR

PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: QËNDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

TIRANË

Në Tiranë sot më datë 29.12.2021

Unë **Enuar V MERKO** Përmbarues Gjyqësor me Liçensë Nr.123 pasi studiova dosjen përmbarimore si dhe në zbatim të Titullit Ekzekutiv, Vendimit Nr. 6821 datë 21.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

KONSTATOVA

Shoqëria "Crimson Finance Fund Albania" sh.p.k, në cilësinë e kreditorit, ka paraqitur pranë Zyrës Përmbarimore "E.G BAILIFF SERVICE" me Përmbarues Gjyqësor Enuar V MERKO, kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Vendimit Nr. 6821 datë 21.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, marrë formë të prerë më datë 02.12.2021 me palë dhe objekt :

- Kreditor : Shoqëria "Crimson Finance Fund Albania" Sh.P.K.
- Debitor : Shoqëria "Minibus Center" Sh.P.K.
- : Gëzime Cara
- : Frederik Cara
- Me objekt : Pagim shume

Pasi janë zbatuar procedurat ligjore të njoftimit drejtuar palës debitore për ekzekutim vullnetar të detyrimit, pala debitore nuk ka kryer ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban Titullit Ekzekutiv, Vendimit Nr. 6821 datë 21.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, marrë formë të prerë më datë 02.12.2021



QENDRA KOMBETARE
E BIZNESIT
Privat

Me vendim të Përmbaruesit Gjyqësor Privat ekzekutimi i Titullit Ekzekutiv, Vendimit Nr. 6821 datë 21.10.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, marrë formë të prerë më datë 02.12.2021 ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Në këto kushte për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, i sipërcituar, duhet të kryhet vendosja e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga pala debitore **Shoqëria "Minibus Center" Sh.P.K. me NUIS L71921017I, Gëzime Riza Cara e datëlindjes 21.04.1992, Frederik Selman Cara i datëlindjes 17.09.1976, me qëllim shlyerjen e detyrimit.**

Nga sa më sipër bazuar në nenin 527 të Kodit Procedurës Civile dhe Ligjit nr. 26/2019 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat"

URDHËROJMË :

1. Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga pala debitore:
 - a. Shoqëria "Minibus Center" Sh.P.K. me NUIS L71921017I me adminisrator znj. Gëzime Cara
 - b. Gëzime Riza Cara e datëlindjes 21.04.1992 për 100% të kuotave që ka në pronësi në Shoqërinë "Minibus Center" Sh.P.K. me NUIS L71921017I
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

PËRMBARUESI GJYQËSOR PRIVAT
ENUAR V MERKO

